

VENDIM
Nr.1588, datë 3.12.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA ALUIZNI, DREJTORIA QENDRORE DHE DREJTORIA RAJONALE E QARKUT TË SHKODRËS, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), drejtorisë qendrore dhe drejtorisë rajonale për qarkun Shkodër, të shtyjnë afatin e botimit të njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, për mallra e ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda datës 31 dhjetor 2008.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja dhe ekzekutimi i kontratave përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, drejtorja qendrore e drejtorja rajonale e qarkut të Shkodrës dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

1. Autoriteti kontraktor: Drejtorja qendrore e ALUIZNI-t
Procedurë e hapur me objekt “Rikonstruksion i disa ambienteve të zyrës qendrore të ALUIZNI-t”.

Loti I: Rikonstruksion i godinës 1-katëshe.

Loti II: Rikonstruksion i zyrës së titullarit.

Loti III: Montim grilash në fasadë dhe vendrojtë.

2. Autoriteti kontraktor: Drejtorja rajonale e ALUIZNI-t për qarkun Shkodër
Procedurë e hapur me objekt “Blerje karburanti për vitin 2008”.